



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna e Istog
Opština Istok
Istog Municipality

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Tel: 038/200 438 14

KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY ISTOG

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e 12-të e Legjislacionit të VI-të të Kuvendit të Komunës së Istogut, mbajtur më: 31.12.2018 (e hënë), në Sallën e Kuvendit të Komunës në Istog, filluar me punë në ora 10:00.

Në mbledhje ishin të pranishëm këta këshilltarë:

- | | |
|---------------------------|-------------------------------|
| 1. Qaush Balaj, LDK; | 13. Eliot Kukiqi, AAK; |
| 2. Zenel Shatri, LDK; | 14. Ardita Idrizaj, AAK; |
| 3. Besa Ferati, LDK; | 15. Jehonë Haxhijaj, AAK; |
| 4. Naim Behlulaj, LDK; | 16. Arben Kabashi, PDK; |
| 5. Luljeta Zeqiraj, LDK; | 17. Ajshe Metaj, PDK; |
| 6. Haki Podrimaj, LDK; | 18. Mirushe Sadikaj, PDK; |
| 7. Selajdin Bytyqi, LDK; | 19. Agron Avdijaj, VV; |
| 8. Valbona Demaj, LDK; | 20. Lavdije Bujupaj, VV; |
| 9. Edona Lubeniqi, LDK; | 21. Radenko Belošević, RB dhe |
| 10. Naim Imeraj, AAK; | 22. Slaviša Maliković, SM. |
| 11. Nexhmedin Balaj, AAK; | |
| 12. Muhamet Ukaj, AAK; | |

Mbledhja ishte e hapur dhe në mbledhje ishin të pranishëm edhe Nënkryetari i Komunës z. Agim Ademaj, drejtorë të drejtorive komunale, përfaqësues të OSBE-së, KFOR-it, përfaqësues të shoqërisë civile, mediave, disa qytetarë etj (lista e nënshkrimeve të evidencës së pjesëmarrjes është pjesë përbërëse e këtij procesverbali dhe e njëjta gjendet në dosje: "shembulli 1")

(Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar edhe CD-të e xhirimit gjenden në dosje: "shembulli 2").

Mbledhjen e kryesoi, Kryesuesi i Kuvendit, z. Qaush Balaj.

Procesverbali

Kryesuesi, përshëndeti të pranishmit. Për nderë të rënies së policit dhe veteranit të UÇK-së Izet Demaj, të renë në krye të detyrës, në mbrojtje të rendit dhe ligjit, kërkoi të mbahet një minutë heshtje. Po ashtu njoftoi se pas përfundimit të mbledhjes do shkojmë së bashku për ngushëllime tek familja e të ndjerit. Kryesuesi, theksoi se për këtë mbledhje është ky :

R e n d d i t e

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
3. Njoftimi me Raportin e punës NP "Ambienti" për vitin 2018 dhe aprovimi i listës së çmimeve për vitin 2019;
4. Njoftimi me Raportin e Performancës nga MAPL për punën e Komunës së Istogut për vitin 2017;
5. Njoftimi me Planin vjetor të punës së Zyrës së Prokurimit për vitin 2019;
6. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim-Vendimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme private me pronën e paluajtshme publike për interes publik;
7. Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit të punës së KKS-së për vitin 2019 dhe
8. Pyetje nga anëtarët e Kuvendit Komunal.

Kuvendi me votim unanim, pa asnjë votë kundër dhe pa abstenime miratoi rendin e ditës.

Në procedurën e votimit nuk morën pjesë: Arif Elshani dhe Radoš Repanović dhe tre anëtarë të kuvendit, të cilët ende nuk janë certifikuar.

Kryesuesi, fjalën ia kaloi Kryetarit z.Haki Rugova .

Kryetari, përshëndeti të pranishmit dhe propozon që edhe nga ana e institucionit komunal të përkrahet familja e Izet Demaj, i cili ka renë në krye të detyrës, pasi që është edhe rasti i parë që bie në mbrojtje të jetës së qytetarëve edhe ne si komunë duhet të përkrahim më një shumë financiare 5,000.00 € (pesë mijë euro) dhe besoj edhe në përkrahjen tuaj. Është rast i veçantë dhe është përkrahur edhe nga qeveria. Gjithashtu po e shfrytëzoj rastin, të ju urojë vitin e ri dhe ju falënderoj të gjithë asamblistëve për punën dhe angazhimin e bërë gjatë këtij viti, njëkohësisht ju njoftojë së për shkak të rastit, kemi anuluar koktejin vjetor, që ka qenë i paraparë të mbahet për fundvit.

Kryesuesi, para së të fillojmë me pikat rendit të ditës për këtë mbledhje besoj së të gjithë do të mbështesni këtë propozim të kryetarit për ndihmë të familjes së Izet Demaj.

Kuvendi më votim unanim, pa asnjë votë kundër dhe pa abstenime miratoi propozimin e Kryetarit për ndihmë financiare për familjen e Izet Demaj. Në procedurën e votimit nuk morën pjesë: Arif Elshani dhe Radoš Repanović dhe tre anëtarë të kuvendit të cilët ende nuk janë certifikuar.

Shqyrtimi i pikës 1.

Kryesuesi njoftoi se për këtë mbledhje për mungesë me arsye është Arif Elshani, AE (rast vdekje) pastaj konstatoi së në mbledhje nuk ishte i pranishëm edhe Radoš Repanović, SL dhe tre anëtarë të kuvendit, të cilët ende nuk janë zëvendësuar nga KQZ-ja për shkak se ende nuk janë certifikuar. Gjithsej në mbledhje janë të pranishëm 22 (njëzetë e dy) këshilltarë.

Shqyrtimi i pikës 2.

Kryesuesi, vazhdoi me pikën e dytë të rendit të ditës, miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Pasi që nuk pati vërejtje dhe diskutime, kuvendi me 21 vota për, 1 abstenim, miratoi procesverbalin nga mbledhja e kaluar.

Agron Avdijaj, abstenon pasi që nuk ka marrë pjesë në mbledhjen e kaluar.

Në procedurën e votimit nuk morën pjesë: Arif Elshani dhe Radoš Repanović dhe tre anëtarë të kuvendit, të cilët ende nuk janë certifikuar.

Shqyrtimi i pikës 3

Kryesuesi, vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës, Njoftimi me Raportin e punës NP "Ambienti" për vitin 2018 dhe aprovimi i listës së çmimeve për vitin 2019 . Lidhur më këtë pikë, fjalën ia kaloi drejtorit Enver Rugova për raportim.

Enver Rugova, Drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike, përshëndet të pranishmit dhe prezanton Raportin e punës NP "Ambienti" për vitin 2018 dhe listën e çmimeve për vitin 2019.

Kryesuesi, fjalën ia kaloi Agron Avdijajt pastaj Arben Kabashit.

Agron Avdijaj, përshëndeti të pranishmit, dhe sa i përket prezantimit të drejtorit dhe raportit të punës që është dorëzuar kam vërejtur se inkasimi është më i dobët tek institucionet publike, është 93 % ndërsa bizneset 110%. Nëse të dhënat janë të sakta. Ndërmarrja duhet të bëjë inkasimin sikur të amvisëritë përmes përmbauesve, të shikojë mundësinë dhe pse mos të bëhet edhe për institucionet publike. Sa i përket shtrirjes dhe grumbullimit edhe këtu po vërehet së pjesa e mbi vades po çalon nga territoret tjera. Ndoshta duhet të fokusohemi më shumë edhe në mbledhjen e mbeturinave në fshatrat tjera. Përveç kësaj ka qenë edhe një

plan i mëhershëm, ku kam lexuar se deri në fund të viti 2018 shtrirja do të arrihet në të gjitha fshatrat. Ndërsa sipas këtij raporti janë vetëm 32(tridhjetë e dy) fshatra, që do të thotë na mbetin edhe një numër i madh i fshatrave. Edhe në këtë raport nuk është saktësuar sa do të rritet edhe pse është cek se do të rritet përfshirja. Nëse saktësohet gjasat për tu realizuar janë më të mëdha. Do ishte mirë disa komente për këtë t'i jap drejtori.

Enver Rugova, falënderon për pyetjet dhe sa i përket pagesës së institucioneve tash në fund të vitit bëhen ato pagesat e komunalive dhe besojë se do të arrijë qind për qindëshin, se edhe ne nuk na lejon mbarëvajtja e punës administrative që të mbesim borxh. Sa i përket shtrirjes në këtë vit kemi fituar një grand prej 146,000.00€ (njëqind e dyzetë e gjashtë mijë euro) nga GIZ-i gjerman, që ka organizuar një garë mes komunash dhe janë pajtuar, që ato të jepen në makineri. Nga ai grant do t'i kemi kamionë me tonazh të madh se paku dy kamionë, të katër ose pesë tonëve, kurse edhe një i takon nga njësia në Pejë. Nëse do t'i kemi tre kamionë besojë se do të afrojmë shtrirjen edhe në ato lokalitete.

Arben Kabashi, përshëndet të pranishmit dhe theksoi nuk e di a jemi në mbledhje të partisë politike apo në seancë të kuvendit. Është hequr flamuri i Amerikës me vendos flamurin partiak. Nuk po më duket e arsyeshme, barra po bie edhe mbi juve Kryesues. Si do që të jetë është përgjegjësi e juaja. Kam dy pyetje, e para është kategoria e bizneseve ka më shumë inkasim se faturim. Si i kanë paguar bizneset mjetet pa faturim dhe e dyta, të kategoria karburant dhe vajra, po më duket pak shumë? Kërkoj sqarim nga drejtori.

Enver Rugova, sa i përket kategorisë, pagesë të bizneseve që është inkasuar më shumë 110% është çështje e përmbaruesit, që ka inkasuar ato të holla nga borxhet e vjetra. Aty e ke të shënuar shumën që do t'i kthehen kompanisë. Ndërsa sa i përket karburantit, kompania i ka kamionët e vjetër, kanë defekte dhe me mund të madh janë duke bërë grumbullimin e mbeturinave. Ajo çka po kalon kompania është mjaftë sfiduese.

Eljot Kukiqi, përshëndet të pranishmit dhe pyet lidhur me 51,000.00 € (pesëdhjetë e një mijë euro) që kanë mbetur, ka do t'i dërgojnë?

Sadik Bujupi, Drejtor i ndërmarrjes "Ambienti", përshëndet të pranishmit dhe së pari i njofton se, raporti i punës është për njëmbëdhjetë muaj dhe jo njëvjeçar. Për këtë arsye nuk janë llogarit edhe ato të muajt të fundit. Gjithashtu bëri një prezantim të këtij raporti, dhe lidhur me pyetjen e asamblistit, sa i përket mbetjeve? Ato para do të mbetin në bankë. Po planifikojmë të blejmë një kamion dhe do të sigurojmë disa kontejnerë (100 kontejnerë) për t'i mbuluar të gjitha pjesët.

Kryesuesi, fjalën ia kaloi Mirushe Sadikajt.

Mirushe Sadikaj, bordi drejtues i Kompanisë "Ambienti", që sa vite është zgjedhur? a ka mandat të përhershëm apo i ka kaluar afati? nëse i ka kaluar afati kisha kërkuar të zgjidhet? dhe a ka konflikt interesi të drejtuesit e Kompanisë "Ambienti"? a ka përfaqësues për momentin dhe sa duhet t'i ketë?

Sadik Bujupaj, ne bord nuk kemi, është bordi në KRM "Ambienti", në Pejë. Ndërsa bordi nuk mundet me qenë, edhe përpara edhe pse ka funksionu, ka qenë gabimisht dhe jo ligjor, sepse ne jemi njësi operative dhe përgjegjësi të KRM "Ambienti". Për momentin nuk kemi përfaqësues. Në KRM janë gjithsej tre përfaqësues.

Naim Behluli, përshëndet të pranishmit, a keni ndonjë datë se kur do të përfshihen të gjitha fshatrat? Dhe propozon me shumën 51,000.00 € (pesëdhjetë e një mijë euro), të blihet kamioni.

Sadik Bujupaj, gjithsejtë janë tetëmbëdhjetë fshatra, pa pasur kamion nuk kemi mundësi. Momentin që e marrim kamionin atëherë fillojmë.

Zenel Shatri, përshëndetje për të gjithë. Ne si asamblistë me të vjetër e dimë së me herët kjo organizatë nuk ka punuar fare, që një vit është përmirësuar. Kam pyetje për drejtorin për ditët e festave. Si është e organizuar heqja e mbeturinave? Për arsye ngase në fshatin tim me 28.11.2018, kanë mbetur dy javë pa u heq mbeturinat. Kam vërejtje edhe nga fshatarët.

Sadik Bujupaj, faleminderit dhe më vjen mirë për pyetjen. Asnjë ditë feste punëtorët e "Ambienti" nuk pushojnë. Por janë edhe do pjesë ku bukur shumë çalojnë më pagesa atëherë edhe vullneti është më i vogël. Po ashtu tri aksione kanë qenë për pastrimin e Istogut dhe asnjë anëtar i asamblesë nuk ka marrë pjesë edhe unë i kam vërejtjet e mia.

Zenel Shatri, ndëshkimi nuk është në rregull.

Agron Avdijaj, nuk e kam të qartë statusin. Më herët është një vendim i kuvendit i vitit 2011, nuk është i vulosur, që është themeluar kjo ndërmarrje lokale apo nuk është shpallë? Në disa dokumente figuron si ndërmarrje lokale, në disa si njësi e Regjionit të Pejës. Ndërsa këtu në raportin aktual figuron deri të merret një vendim varet nga niveli qendror. Niveli qendror ka marr vendim që iu lejon komunave të themelojnë ndërmarrje lokale publike. Disa komuna e kanë themeluar ndërmarrje lokale si ajo e Vushtrisë, a është në plan edhe për komunën tonë apo nuk shihet si e leverdishme kjo?

Sadik Bujupaj, në Kosove janë pesë KRM. Iniciativa ka qenë për tu shkëput Istogu dhe është bërë regjistrimi i aseteve por kanë ndërhy dhe nuk është lejuar.

Tani kanë filluar si pilot projekt në disa komuna: Prishtina, Prizreni, Vushtrria etj. Tani jemi në radhe edhe ne, Komuna e Istogut.

Ajshe Metaj, përshëndet të pranishmit, desha t'i tregojë drejtorit se shpesh kemi marrë pjesë në pastrim së bashku me nxënës dhe ajo që tha për shumicën nuk vlen. Edhe rreth atyre të hollave që kanë tepruar gjatë këtij viti po dua të ndërlihem. Nga të hyrat dhe inkasimi për këtë vit, ne kemi kërkuar në KPF që më i siguru edhe nga dy a tri vite të ardhshme me bë krahasimin e atyre të ardhurave të inkasimeve, si dhe planifikimin e atyre të ardhurave ku janë dërguar ato të holla. Në mënyre që të bëhet një planifikim më i mirëfilltë këtë vit, të blihen mjetet, kontejnerë apo gjëra tjera për këtë vit.

Enver Rugova, ne e kemi diskutuar edhe në komitet, ne i kemi kërkuar ndërmarrjes të zgjerohet. Që dhjetë vite jam në kuvend dhe asnjëherë kjo ndërmarrje nuk kanë blerë, por këta duhet të ndajnë mjete për amortizim të automjeteve në një masë më të madhe kësaj radhe dhe vitin e ardhshëm urojë të kenë sukses më të madh. Pagat nuk janë rritë që nga ndarja me Kompaninë e Hidrodrinit. Sa i përket ndarjes është draft ligji që iu mundëson komunave ta kenë, kemi shembull Deçanin, që është ndarë por nuk ka fituar grant. Ne dhe Klina e kemi fituar grantin i marrim edhe në kuadër të KUR''Ambienti'', Pejë, i marrim tre kamionë. Komunat më të mëdha e kanë katër komuna pilot projekt që kanë filluar me faturim, po kanë probleme mjaftë.

Kryesuesi, fjalën ia kaloi Ajshe Metaj.

Ajshe Metaj, pyetje për drejtorin. Te ndarja e mjeteve për amortizim ndoshta më shumë shkojnë mjete për amortizim se sa me ble një mjet tjetër? Më e arsyeshme është të blihet një automjet i ri dhe të behët shtrirja më e madhe se tani inkason më shumë?

Agim Ademaj, mirë do ishin gjithë kamionët e ri.

Kryesuesi, pyet se kush është që të miratohet lista e çmimeve?

Enver Rugova, nuk është e nevojshme të miratohet ngase është vetëm njoftim.

Kryesuesi, atëherë po votojmë?

Kuvendi më votim unanim, pa asnjë votë kundër dhe pa abstenime miratoi Listën e çmimeve për vitin 2019.

Në procedurën e votimit nuk morën pjesë: Arif Elshani dhe Radoš Repanović dhe tre anëtarë të kuvendit, të cilët ende nuk janë certifikuar.

Shqyrtimi i pikës 4

Kryesuesi, vazhdon me pikën e katërt të rendit të ditës: Njoftimi me Raportin e Performancës nga MAPL-ja për punën e Komunës së Istog për vitin 2017. Për këtë pikë të rendit të ditës, fjalën ia kaloi nënkryetarit Agim Ademaj.

Agim Ademaj, përshëndeti të pranishmit, Raporti i performancës së Istogut hyn në raportin e përgjithshëm të viti 2017. Komuna e Istogut ka dalë diku e pesta. MAPL-ja bënë mbikëqyrjen dhe vlerësimin në fusha të caktuara dhe ka dalë më këtë raport. Janë gjithsejtë dymbëdhjetë fusha ku është bërë vlerësimi. Diku qëndron më mirë e në disa vende më pak. Si shpërblim të kësaj kemi marrë 135,000.00 € (njëqind e tridhjetë e pesë mijë euro). Një shtesë tjetër më vonë kemi fituar edhe 30,000.00 € (tridhjetë mijë euro). Total janë 165,000.00 € (njëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë euro). Të gjitha komunat janë monitoru, të shohim si dalim për 2018.

Ajshe Metaj, falënderon për fjalën dhe pyeti së në cilën fushë është më e ulët. Isha përqendruar të çështja e ankesave lidhur me skemën sociale. Nëse është fitu ky grant kisha dashtë mu përqëndru pak a shumë në çështjen e skemës sociale. Duke ditur këtu së është pjesa më e ndjeshme e shoqërisë, prej së cilës ajo mbijeton nga skemat sociale. A ka punëtorë me aftësi të kufizuar në institucionin komunal, a ka ndonjë konkurs për tu punësuar?

Agim Ademaj, të fusha e dhjetë, furnizimin e qëndrueshëm me ujë të pijshëm. Ju e dini kemi telashe me ujë të pijshëm për shkak të keqpërdorimeve që ndodhin. Sa i përket skemës sociale e kemi diskutuar në komitet, këtë e vlerëson Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Ata i kanë kriteret caktuara, i hjekun, i vendosin. Ndikimi është i pakët, kemi katër ankesa në komunë por nuk kemi mundësi më ndërhy. Kemi edhe persona më aftësi të kufizuar që janë të punësuar, mirë është të iu jepet përparësi ku lejon ligji.

Kryesuesi, fjalën ia kaloi Agron Avdijajt pastaj Arben Kabashit.

Agron Avdijaj, në kuadër të kësaj performancë jo e mirë është edhe rekomandimi, përfshirja e grave në vendimmarrje. Kjo ka qenë edhe premtim i kryetarit që do ta ketë parasysh këtë. Unë kisha propozuar që të behët një plan nga komuna jo vetëm për këtë por edhe pikat tjera ku ka nevojë të përmirësohet.

Arben Kabashi, përshëndeti të pranishmit dhe falënderon për fjalën. Pak a shumë u përmenden të gjitha. Por të përfshihet një performancë në dy faqe besoi edhe ju jeni të pajtimit së kjo është e pamundur. Sidoqoftë në këtë raport ka edhe shumë paqartësi, ne e kuptojmë se është pak model maskimi ose termet e përdorura janë shumë pak informative dhe aty ka nivele të përqindjes që si dihet se të cilit shërbim janë. Shembull të mirëqenia sociale, ec e dije çka quajmë

mirëqenie sociale në këtë rast. Kam disa pyetje, në secilën prej rekomandimeve çka kanë bërë drejtoritë përkatëse në ngritjen e performancës? Por pak a shumë u përmenden të çështja e ankesave dhe skemat e ndihmës sociale, trajtimi i ujërave të zeza, punëtorët me aftësi të kufizuar në institucione komunale, parkingjet, hapësirat publike e kështu më radhë. Nuk është një raport me dy faqe që më ngrit një performancë në nivelin e përqindjes çfarë e kanë sjellë.

Agim Ademaj, unë vetëm një fjalë dhe drejtoresha pastaj do e mer fjalën. Është raporti që është dërguar në ministri shumë voluminozë dhe dosje që është punuar gjatë tërë vitit. Ata e kanë nxjerre një raport të tillë. Dhe ky raport është paraqitur para jush. Ndërsa dosja që është punuar gjatë tërë viti në gjitha këto sfera është e pamundur të sjellët një raport i tillë para jush por ky është i përpunuar.

Edona Bujupi-Loxha, Drejtoreshë e Drejtorisë për Administratë Komunale, përshëndeti të pranishmit, me krenari mund ta themi se për tri vite më radhë Komuna e Istogut, është ndëre pesë komunat më të mira sa i përket performancës komunale, ku edhe shpërblehemi me grante. Sa i përket të gjeturave, sfidave dhe arritjeve, lirisht mund të themi që për tri vite me radhë, duke marrë parasysh që kemi shku duke u përmirësuar dhe kemi fituar grante të performancës atëherë normalisht që kemi edhe përmirësime. Sa i përket pikës, personave me nevoja të veçanta, një përmirësim nuk thuhet "me aftësi të kufizuara por me nevoja të veçanta". Ju kisha lut që tani e tutje ta keni parasysh. Sa i përket personave me nevoja të veçanta, komuna jonë vazhdimisht bënë përpjekje por ligji nuk na lejon që të kenë më shumë prioritet, më shumë personat me nevoja të veçanta gjatë aplikimit në punë. Komuna e Istogut ka Zyrën për barazi gjinore dhe Koordinatorin për drejta të njeriut që merret me këtë çështje, po ashtu e kemi edhe Ligjin kundër diskriminimit. Në komunën tonë kemi edhe persona me nevoja të veçanta që janë të punësuar. Sa i përket pyetjes për gratë në vendimmarrje, kjo vazhdon jo vetëm në komunën tonë por edhe në komunat tjera. Mirëpo kryetari asnjëherë nuk ka dhënë premtim që do të marrë femra në vendimmarrje, ka thënë "do shohim mundësitë". Kjo do kishte qenë e mirë edhe për mua dhe për të gjitha femrat në komunën tonë. Por prapë se prapë është vendim i kryetarit. Prapë po them jeni të ftuar të jepni rekomandime por duke marrë parasysh që tri vite shpërblehemi, këtë vit e kemi synim, që vitin e ardhshëm të shpërblehemi dhe të jemi komuna e parë në Kosovë, sa i përket performancës komunale.

Kryesuesi, fjalën e ka Ajshe Metaj.

Ajshe Metaj, desha t'i tregojë drejtoreshës se ne nuk i kemi shkruar këtë raport. E fjalori që duhet mu përmirësu "me nevoja të veçanta" nuk është ndonjë problem i madh. Ne këto nuk i kemi marrë nga qielli e as kozmosi por po thotë këtu, çështja përfshirja e personave me aftësi të kufizuar. Ne nuk jemi t'i lëndojmë ata

persona dhe na vjen keq prej tyre. Përkundrazi ne kemi dëshirë të iu ndihmojmë dhe të jenë të barabartë në shoqëri, se fjalori i ra sikur u rëndove nga fjalët. Mirëpo kështu shënon raporti me rekomandim, faleminderit.

Kryesuesi, Arben Kabashi e ka fjalën pastaj **Naim Imeraj**.

Arben Kabashi, megjithëse profesoresha e përmirësoi drejtoreshën se është e painformuar. E tha me entuziast raporti i performancës, me hy me fakte krejt realiteti është tjetër gjë. Ndoshta me hy me fakte me i tregu drejtoreshës së nuk po dojmë me hy, se drejtorinë që e udhëheq ajo është menaxhuar më se dobëti. Rekomandimet sidomos për punësimet është një temë që nuk ka fund andaj mos të përmendim emra.

Kryesuesi, megjithatë ne e kemi si njoftim këtë pikë të rendit të ditës.

Naim Imeraj, përshëndet të pranishmit. Ashtu siç tha edhe nënkryetari është një raport i shkëputur nga njëmijë e diçka faqe. Pa intencë që të nxis debat, dy faqe kanë qenë dhe dy faqe janë përcjell bile kam pas problem me shtyp. Ajo që jam më kureshtar, ekziston një fushë faqe dyzet e katër, kisha dashtë me ditë çka përfshinë kjo fushë, pse kemi ngec, pse nuk kemi mund me qenë më mirë?

Edona Bujupi-Loxha, vetëm një përmirësim të vogël **Arben**. Shërbimet administrative komunale janë prej 100%, 98, 18%. Transparenca komunale është 90, 69 % prej 100%. Qe do të thotë, herën tjetër kur sulmosh mendo mirë para se të bëni sulmin për shkak se dokumenti tregon se administrata komunale prej 100% 98,80%, i ka kryer të gjitha me përpikëri.

Kryesuesi, Arben Kabashi ka kërkuar replikë.

Arben Kabashi, nëse e ke lexu mirë raportin e auditimit të vitit të kaluar e sheh mirë sa ki performancë të mirë. I ki mbi dyzetë të pranuar me kontratë mbi vepër. E vetmja komunë që ka më se shumti të punësuar kontratë mbi vepër. Mos të hy temave tjera se drejtoresha po don debat. Është drejtorati më keqpërdorues, me mirë të themi menaxhimin me të dobët, që më vjen keq që je në kuadër të cilësisë së gjinisë që unë i dha përparësi shumë. Po performancë të mirë ne e dimë sa keni.

Agim Ademaj, **Naim** tentova me paraqit një raport të performancës, është ky që është. Ne jemi te peste, kemi të meta që do mundohemi me i eliminu. E kuptova drejtë, ju po pyesni fusha e katërmbëdhjetë çka përfshinë? **Faton Bytyçi** është këto dhe mundet me na tregu ma gjerësisht për këtë raport nëse doni? **Arben** janë edhe raportet e punës mundeni më i prek temat.

Shqyrtimi i pikës 5

Kryesuesi, vazhdon me pikën e pestë të rendit të ditës: Njoftimi me Planin vjetor të punës së Zyrës së Prokurimit për vitin 2019. Ky plan ka kaluar në KPF me një rekomandim, që një projekt të kaloi nga muaji korrik në muajin mars, është fjala për ndërtimin e një kanali të ujitjes. Fjalën ia kaloi nënkryetarit.

Agim Ademaj, ky plan përfshinë një planifikim rreth zyrës së Prokurimit për ato që ju i keni aprovuar këtu hynë edhe mallrat dhe shërbimet së çka do të punohet. Sigurt nuk do të jete strikt kështu, do këtë edhe lëvizje. E kemi rekomandimin e komitetit, unë jam me përkrah, nëse është nga grandet mund të bëhet nëse është nga të hyrat vetanake është pak problem deri të startojmë me të hyrat. Parimisht e përkrahim, urdhëroni vërejtjet. Keni parasysh vërejtje në projekte nuk keni çka me ba vetëm për afate.

Kryesuesi, buxheti është aprovuar, realizimi parashihet përmes këtij plani nga zyra e prokurimit. Fjalën ia kaloi Ajshe Metajt.

Ajshe Metaj, kam një kërkesë për një projekt: "Kubëzimi i trotuareve në Saradran", nr.18, që është paraparë në muajin prill. A ka mundësi më herët të realizohet projekti sepse rrezikshmëria është e madhe për ata fëmijë. Nuk e di a është i evidentuar në procesverbal.

Shqyrtimi i pikës 6

Kryesuesi, vazhdon me pikën e gjashtë të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim - Vendimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme private me pronën e paluajtshme publike për interes publik. Fjalën ia kaloi Agim Ademajt.

Agim Ademaj, kemi të bëjmë me një ndërrim është hapur një rrugë e re është asfaltuar. Iu është marrë pronarit toka dhe duhet ta bëjmë kompensimin. Këtu është edhe stafi mbështetës. Ky ndërrim bëhet edhe me vlerësim të ministrisë që është departamenti i posaçëm në Ministri të financave që jep vlerësimin dhe mendimin përfundimtar. Kjo është nëse ka dikush diçka urdhëroni.

Kryesuesi, fjalën e ka kërkuar Naim Imeraj.

Naim Imeraj, falënderon Kryesuesin për fjalën. Theksoi se duhet të kemi parasysh, shpesh po ka gabime teknike në këto dokumentacione që vijnë. Unë mendoi se edhe ky draft vendim ka gabime teknike. Nëse merren dimensionet që janë dhënë në këtë draft dhe shndërrohen në metër katror nuk është kjo vlerë: $70 \times 7 = 490 \text{ m}^2$, si dhe $29.30 \times 7 = 205.1 \text{ m}^2$ dhe sipas kësaj kemi $490 \text{ m}^2 + 205.1 \text{ m}^2 = 695.1 \text{ m}^2$ e jo 690 m^2 , siç është në propozim-vendim. Edhe nuk janë letrat

korresponduese që hiqen prej parcelave veç e veç, ka gabim teknik. Kisha lutë Drejtorinë e Kadastrës, së paku ta evidentojnë se ka gabim dhe mos të shkojë në procedura më tutje pa u përmirësuar ose pa u sqaruar pretendimet e mia që ka gabim teknik. Duhet të përmirësohet ky gabim. Përndryshe edhe herëve tjera kam pasur pak rezervë. Nëse dikujt i mundësohet kompensimi e dikujt jo për një të mirë të përgjithshme, atëherë kemi pak probleme se diku ka vullnet me heqë dorë e diku nuk ka dhe vijmë në këto situata. Por prapë së prapë është diçka para të cilës jemi. Nëse ekziston marrëveshja që kjo të bëhet atëherë është pjesë e jona e përgjegjësisë që të japim dritën e gjelbër, që kjo të shkojë në procedurë. Por kemi pasur edhe raste tjera që kemi mund me paramendu që është një presion, që thjesht nuk ka pasur vullnet të mirë. Është një sipërfaqe prej 600 m² nuk është e vogël në sipërfaqe gjatësore edhe e shohë që normal e ka pasur të vështirë personi përkatës me heqë dorë por kemi edhe raste në atë kuptimin që ka vullnet të mirë, po prapë se prapë nuk po dua të them se po bëjmë diçka keq, unë jam për.

Agim Ademaj, mund të jetë ashtu siç thatë, të shikohet më mirë propozim-vendimi. Duhet të shikojmë edhe anën ligjore dhe t'i mbledhin numrat më mirë. Ne nuk kemi fond të posaçëm, unë jam për t'i kompensuar të gjitha rastet. Rastet ekstreme po duhet tokë me tokë, qëndron kjo edhe unë jam ithtar i asaj. Larg asaj dikush të kompozohet e dikush jo. Ka raste që merret ndonjë hapësirë e vogël edhe vet pronarët po kanë vullnet të mirë.

Kryesuesi, pyet se kush është që ky të miratohet, kush është kundër dhe nëse ka abstenime?

Kuvendi më votim unanim, pa asnjë votë kundër dhe pa abstenime miratoi Propozim-Vendimin e Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme private me pronën e paluajtshme publike për interes publik, me vërejtjet e parashtruara nga Naim Imeraj.

Obligohet Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër, që këto vërejtje (gabime teknike) t'i korrigjoj në propozim-vendim para se të dërgohet për shqyrtim të ligjshmërisë.

Në procedurën e votimit nuk morën pjesë: Arif Elshani dhe Radoš Repanović dhe tre anëtarë të kuvendit, të cilët ende nuk janë certifikuar.

Shqyrtimi i pikës 7

Kryesuesi, vazhdon me pikën e shtatë të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit të punës së KKS-së për vitin 2019. Fjalën ia kaloi nënkryetarit.

Agim Ademaj, nënkryetar, atëherë këtë plan e keni para jush dhe jemi të obliguar që të kalojmë në kuvend. A keni diçka rreth këtij plani?

Kryesuesi, pasi nuk ka diçka në lidhje me këtë po votojmë për këtë plan.

Kuvendi më votim unanimit, pa asnjë votë kundër dhe pa abstenime miratoi Planin të punës së KKSB-së për vitin 2019.

Në procedurën e votimit nuk morën pjesë: Arif Elshani dhe Radoš Repanović dhe tre anëtarë të kuvendit, të cilët ende nuk janë certifikuar.

Shqyrtimi i pikës 8

Kryesuesi, vazhdon më pikën e fundit të rendit të ditës: Pyetje nga anëtarët e Kuvendit Komunal. Fjalën e ka kërkuar Enver Rugova.

Enver Rugova, vetëm desha të ju njoftoj se ju kemi përgjigjur pyetjeve të Arif Elshanit.

Pasi që nuk pati diskutime të tjera, Kryesuesi shpalli të mbyllur mbledhjen e Kuvendit të Komunës.

Mbledhja përfundoi me punë në ora, 11:35.

Procesmbajtëse,
Arlinda Kurtaj



Kryesues,
Qaush Balaj